



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Analiza Politike 2010/5

# **Rishikim i Procesit të Decentralizimit Funksionimi i Komunave me Shumicë Serbe**

Prishtinë, korrik 2010

Ky projekt është përkrahur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Kosovë.

Përgatitur nga: Krenar Gashi

Copyright © 2010 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rexhep Mala, 5A, Kati II

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefon dhe Fax: +381 38 227 778

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## **Përmbajtja**

I. HYRJE.....	4
II. KORNIZA LIGJORE DHE AGJENDA LEGJISLATIVE .....	5
III. ZGJEDHJET LOKALE – VULOSJA E SUKSESIT .....	6
IV. BARTJA E PUSHTETIT DHE DOKUMENTACIONIT .....	7
V. QEVERISJA NË KOMUNAT E REJA - MUNDËSITË DHE SFIDAT .....	10
VI. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....	12

## I. Hyrje

Me implementimin e decentralizimit, që rrjedh prej Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (PGJMSK), Kosova po futet në një fazë të re të zhvillimit të marrëdhënieve ndëretnike. Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009, ka krijuar një klimë të volitshme për bashkëjetesë ndërmjet dy komuniteteve kryesore – shqiptarëve dhe serbëve – duke e vulosur suksesin e procesit të decentralizimit në Kosovë.

Krijimi i komunave të reja në vija etnike ka sjellë pushtetin më afër komuniteteve që jetojnë aty. Deri tani janë krijuar katër komuna të reja me shumicë serbe. Krijimi i komunës së pestë, asaj të Mitrovicës së Veriut, mbetet për fund të këtij viti. Për më tepër, autoritetet kosovare kanë krijuar dy komuna të reja në zona të banuara nga shqiptarët, Juniku dhe Hani i Elezit, si dhe një njësi komunale në Mamushë, vendbanim ky i populluar nga turq të Kosovës.

Numri i përgjithshëm i serbëve që kanë votuar në këto zgjedhje, të parat që janë organizuar në Kosovën e pavarur, ka qenë dhjetë herë më i madh se ai në zgjedhjet e Nëntorit 2007, të cilat ishin organizuar nga misioni i OKB në Kosovë (UNMIK). Numri i serbëve që kanë votuar ka qenë gjithashtu më i madh se ai në zgjedhjet e organizuara nga Serbia në maj të vitit 2008 dhe gusht 2009. Një sukses mbresëlënës i këtij procesi elektoral kanë qenë zgjedhjet e organizuara në komunën e sapokrijuar të Parteshit. Më shumë se 65% të serbëve të regjistruar në këtë komunë kanë dhënë votën e tyre në zgjedhjet e organizuara nga Kosova më 20 qershor 2010.

Komunat me shumicë serbe, me përjashtim të Parteshit, kanë formuar kuvendet komunale dhe qeveritë lokale në këto komuna. Prosesi i fuqizimit të plotë të këtyre komunave është në vazhdim, me bartjen graduale të pushtetit nga niveli qendror si dhe fuqizimin e kapaciteteve për ekzekutimin e pushtetit lokal. Administratat e reja po ballafaqohen me një kërkesë të lartë për shërbime nga popullata lokale. Kjo shënon një sukses të procesit të decentralizimit, duke treguar që serbët janë të gatshëm të integrohen në kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës. Ky proces po e diskrediton në mënyrë efektive idenë e ndarjes së Kosovës dhe po i jep një shtytje të re procesit të ndërtimit të një shteti multietnik.

Suksesi i decentralizimit e paraqet kornizën më të fortë institucionale dhe ligjore nëpërmjet të cilës shqiptarët dhe serbët e kanë një mundësi historike për të punuar së bashku. Kjo e përmirëson mundësinë për bashkëjetesë duke pasur parasysh dy dekadat e ndarjes institucionale pas konfliktit të armatosur. Ky numër i personave që dolën në votime ka qenë një mesazh i qartë që serbët e Kosovës, sidomos ata që jetojnë në jug të lumit Ibër, kanë humbur besimin në qeverinë e Serbisë dhe institucionet e saj paralele që veprojnë në Kosovë. Megjithatë formimi i qeverive lokale nuk i ka dhënë fund këtyre strukturave, kjo përsëri konsiderohet si një kthesë madhore e ndjenjave politike dhe sociale të popullatës serbe të Kosovës.

Në këtë studim, KIPRED do të shqyrtojë zhvillimet e fundit në procesin e decentralizimit pas përfundimit të suksesshëm të procesit zgjedhor dhe formimit të autoriteteve lokale me shumicë serbe në komunat e reja. KIPRED do të ekzaminojë procesin e decentralizimit, bartjen e përgjegjësisë nga autoritetet qendrore në ato lokale, transferimin e të dhënave në komunat e reja por gjithashtu ngjyrimin politik dhe shoqëror të këtij procesi.

## II. Korniza Ligjore dhe Agjenda Legjislative

Komunat janë njësisia bazë e vetëqeverisjes në Kosovë që mund të ekzekutojnë pushtetin ekskluziv dhe të deleguar. Ligji i ri për Vetëqeverisjen Lokale ka zgjeruar fushat mbi të cilat komunat kanë kompetenca ekskluzive. Ky ligj, bashkë me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave dhe atë për Financat e Pushtetit Lokal, e rregullojnë pushtetin lokal në Kosovë.

Kjo kornizë ligjore determinon që komunat duhet ti ushtrojnë kompetencat e tyre në përshtatje me parimin e subsidiaritetit. Kjo gjithashtu merr parasysh parimet e vetëqeverisjes lokale të përfshira në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale si dhe Protokollin e saj, Kornizën e Konventës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, Kartën Evropiane për Gjuhë Minoritare ose Rajonale dhe Konventa Kornizë Evropiane mbi Bashkëpunimin Ndërkufitar ndërmjet Komuniteteve Territoriale ose Autoriteteve dhe Protokollin e saj.

Gjatë implementimit të planit të decentralizimit, sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, autoriteteve të Kosovës i është dashur të bëjnë ndryshime në 35 ligje, në mënyrë që të zhvendosin procesin vendimmarrës nga pushteti qendror në qeveritë komunale.

Raundi i fundit i ndryshimeve ligjore që do të ndikojnë në procesin e decentralizimit dhe në qeverisjen komunale në përgjithësi ka lidhje me ligjet që do të rrisin kualitetin e shërbimeve komunale. Ligji për Shërbyesit Civil është vënë në agjendën ligjore të Asamblesë. Me miratimin e këtij ligji, Mistria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e shih përfundimin e kornizës ligjore për procesin e decentralizimit.<sup>1</sup> Sidoqoftë, meqë shumica e legjislacionit ka qenë i draftuar ose amandamentuar në një periudhë shumë të shkurtë kohore, disa hapësira dhe mospërkatje janë identifikuar në kohë.

MAPL e ka krijuar një grup punues për të amandamentuar ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë grup punues janë përfshirë gjithashtu përfaqësues të shoqërisë civile . Ndryshimet e sugjeruara kanë qenë të lidhura me transparencën e veprimtarisë komunale, demokracinë e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes të qytetarëve në nivelin komunal.<sup>2</sup> MAPL ka vazhduar me ndryshimet të cilat do të rishikohen nga një grup ndërministror, para se të dërgohen në Asamble për miratim.

Qeveria e Kosovës është kritikuar për vonesën e miratimit të ligjit për huamarrje, në bazë të cilit komunat mund të aplikojnë për grante dhe borxhe në mënyrë të pavarur.<sup>3</sup> Projektligji që është përgatitur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa (MEF) nuk është miratuar sepse qeveria akoma po konsideron nëse kjo e drejtë duhet tu delegohet komunave.<sup>4</sup> MAPL konsideron që komunat nuk i kanë kapacitetet e nevojshme që të menaxhojnë borxhet dhe kreditë e huaja.<sup>5</sup> Sidoqoftë, një kompetencë e tillë është paraparë në Ligjin për Vetëqeverisje, bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, ndërsa ligji special duhet të vendosë detajet mbi

---

<sup>1</sup> KIPRED intervistë me Besnik Osmani, Sekretari Permanent i MAPL, Prill 2010

<sup>2</sup> KIPRED ka qenë një nga tre grupet e shoqërisë civile që kanë marrë pjesë në këtë grup punues

<sup>3</sup> Qeveria nuk ua beson çështjet financiare drejtuesve komunalë, Koha Ditore Qershor 28, 2010, faqe 7

<sup>4</sup> Ibid

<sup>5</sup> Ibid

mënyrën se si komunat mund të aplikojnë për kredi dhe grante të tjera, në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në anën tjetër, sipas legjislacionit të tanishëm, komunat e Kosovës kanë autonomi në ushtrimin e kompetencave të tyre ekskluzive dhe të deleguara.<sup>6</sup> MAPL është autoriteti i përgjithshëm mbikëqyrës për veprimet e komunave.

Qeveria e Kosovës nuk mund të anulojë vendimet komunale – ligjore ose ekzekutive – edhe nëse ato nuk ndjekin ligjin e Kosovës ose Kushtetutën.<sup>7</sup> Në raste të tilla, qeveria mund të kërkojë që komuna të rishikojë vendime ose vepra të tilla.<sup>8</sup> Kërkesa duhet të konstatojë bazat ligjore ose kushtetuese të shkeljes së supozuar dhe nuk do të pezullojë ekzekutimin e vendimit ose veprimit komunal të përfolur.<sup>9</sup> Pastaj, komunat janë të obliguara të përgjigjen kërkesave të tilla për rishikim brenda 30 dite pas njoftimit nga qeveria. Nëse komunat nuk përgjigjen brenda afatit kohor, ose përgjigjen negativisht ndaj rishikimit të një veprimi, qeveria mundet vetëm të sjellë çështjen para një gjyqi përkatës ose para Gjykatës Kushtetuese.<sup>10</sup>

Kjo mungesë e mundësisë për ndërhyrje nga qeveria është arsyeja e vetme e frikës së qeverisë qendrore për funksionalizimit të plotë të komunave të reja. Qeveria qendrore druan se në disa vite komunat e reja do të veprojnë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligje të tjera. Sidoqoftë, kjo frikë është e pabazë. Qeveria ka të drejtë të plotë ligjore për të shpërndarë asamblatë komunale dhe për të shpallur zgjedhje të reja. Kjo frikë e paarsyeshme është bërë një shtytës politik për të ngadalësuar procesin e përgjithshëm të decentralizimit.

### III. Zgjedhjet Lokale – Vulosja e Suksesit

Zgjedhjet e Kosovës të 15 Nëntorit 2009, si dhe balotazhin e 13 Dhjetorit 2009, kanë qenë kyçe për suksesin e procesit të decentralizimit. Një pjesëmarrje e kënaqshme e serbëve të Kosovës në këto zgjedhje e ka legjitimuar krijimin e komunave të reja si dhe ka krijuar lidhshmëri lokale të ligjshme serb. Në zgjedhjet komunale të organizuara nëpër Kosovë, serbët fituan në tre komuna – Graçanicë, Ranillugë, Kllokot/Vrbovac dhe Shterpcë; kanë humbur në Novo Bërdën tanimë të zgjeruar. Në tre komunat në veri nuk ka pasur virtualisht fare pjesëmarrje – Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Në atë kohë, zgjedhjet në Partesh dhe Mitrovicë të Veriut nuk janë organizuar sepse këto dy komuna nuk ishin krijuar akoma.

Zgjedhjet në komunën e Parteshit u organizuan më 20 qershor 2010, pasi që përgatitjet për këtë komunë të porsa krijuar përfunduan. Rreth 65% nga 3508 votuesit e regjistruar e dhanë votën e tyre duke zgjedhur anëtarë të asamblesë komunale dhe dy kandidatë për balotazh të kryetarit të komunës. Balotazhet u mbajtën më 18 korrik 2010 ku Nenad Cvetković nga Iniciativa Qytetare Zavicaj fitoi 58% të votave duke mundur rivalin e tij Todor Mirković nga Lista e Bashkuar Serbe. Cvetković ka pasur mbështetje të madhe

---

<sup>6</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kapitulli I

<sup>7</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kapitulli X

<sup>8</sup> Ibid

<sup>9</sup> Ibid

<sup>10</sup> Ibid

nga qeveria e Kosovës, përfshirë këtu mbështetje financiare, ndërsa Mirkoviq ishte i mbështetur nga qeveria e Serbisë.

Dalja e madhe në votime e serbëve lokal në zgjedhje të organizuar nga autoritetet kosovare e ka vulosur suksesin e planit të decentralizimit dhe krijimin e komunave të reja. Ky numër i njerëzve që dolën në votime ka qenë gjithashtu kundërshtimi më i fortë i dhënë nga komuniteti serb strukturave paralele serbe që veprojnë në Kosovë.

Dalja në votime ka qenë një surprizë gjithashtu për përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, sidomos për anëtarët e Kuintit, të cilët kanë qenë ngurrues për të vazhduar me formimin e komunave të reja në fund të 2009.<sup>11</sup> Formimi i komunave të reja si dhe zgjedhja e kryetarëve dhe asambleve ka qenë një sukses i madh, pa marrë parasysh pengesat e ndryshme. Shumica e vendimeve të lidhura me krijimin e komunave të reja për zgjedhjet e 15 nëntorit janë bërë në moment të fundit.<sup>12</sup> Mungesa e konsensusit ndërmjet vendimmarrësve ndërkombëtarë në Kosovë, për sa i përket krijimit të komunave të reja, e ka paralizuar Qeverinë e Kosovës. Për më tepër, konfliktet përbrenda komunitetit ndërkombëtar në Kosovë gati e kanë sjellë procesin e decentralizimit buzë dështimit. Lista finale e komunave në të cilat do të mbaheshin zgjedhjet është vendosur vetëm disa orë para afatit të fundit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për certifikimin e kandidatëve që do të merrnin pjesë në këto zgjedhje. Disa kandidatë serbë janë ankuar se nuk mund të aplikojnë për certifikim, pasi që nuk e dinin nëse do kishte komuna të reja në të cilat duhet të merrnin pjesë apo jo.

Zgjedhjet treguan se Partia e Pavarur Liberale (SLS), që është pjesëmarrëse në institucionet e Kosovës, doli si entiteti dominant politik i Serbëve të Kosovës. SLS fitoi në Graçanicë, Kllokot/Vërbovac, Ranillugë dhe Shtërpce. Serbët humbën në Novo Brdë, pavarësisht nga fakti që ata përbëjnë rreth 75% të popullatës totale në këtë komunë. Dalja në votime ishte e ulët për shkak të presionit ekstrem nga institucionet paralele dhe Beogradi. Në tërësi, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në këto zgjedhje ishte dhjetë here më e madhe se pjesëmarrja në zgjedhjet e vitit 2007 që u organizuan nga Misioni i OKB në Kosovë (UNMIK).

#### **IV. Bartja e Pushtetit dhe Dokumentacionit**

Në të tre komunat, Graçanicë, Ranillugë dhe Kllokot/Vërbovac, kuvendet komunale janë krijuar dhe janë bërë funksionale. Kuvendi Komunal Graçanicës është formuar në 29 dhjetor 2009, Kuvendi Komunal Ranillugut më 4 Janar 2010, dhe ai i Kllokotit më 8 janar 2010. Këto kuvende kanë adoptuar legjislacionin e nevojshëm për të vazhduar punën e tyre. Gjithashtu kanë formuar Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete – që janë të obligueshme me ligj. Komunat gjithashtu kanë filluar të ndërtojnë administratën dhe të rekrutojnë stafin. Procesi i punësimit të stafit ka përparuar deri në rreth 60%.

Kjo përqindje është diçka më e vogël në Komunën e Parteshit, ku strukturat komunale janë zgjedhur vetëm në qershor 2010. Kjo komunë duhet të bëhet funksionale në gusht apo shtator 2010.

---

<sup>11</sup> Decentralizimi në Kosovë II – Sfidat e komunave me shumicë serbe, KIPRED, Dhjetor 2009

<sup>12</sup> Ibid

Sipas grupeve punuese për decentralizim që janë të koordinuara nga MAPL, procesi i bartjes së pushtetit nga autoritetet qendrore te komunat gati ka përfunduar.<sup>13</sup> Pushteti që komunat do të marrin nga procesi i decentralizimi është ndarë në tre kategori. Kategoria e parë është ajo e kompetencave të vetë komunës siç është e definuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.<sup>14</sup> I gjithë pushteti dhe kompetencat nga kjo kategori janë transferuar te komunat.<sup>15</sup>

Kategoria e dytë përbëhet nga pushteti i deleguar, domethënë regjistri kadastral, regjistri civil, regjistrimi i votuesve, regjistrimi i bizneseve dhe licencimi, shpërndarja e pagesave për asistencë sociale dhe mbrojtja e pyjeve.<sup>16</sup> Deri tani nuk ka pasur përparim në bartjen e pushtetit për shpërndarjen e pagesave për asistencë sociale, pushteti mbi mbrojtjen e pyjeve është në proces të bartjes ndërsa regjistrimi i bizneseve dhe licencimi është transferuar vetëm në 10 komuna.<sup>17</sup> Pjesa tjetër e pushtetit është bartur në mënyrë të suksesshme në komuna.<sup>18</sup>

Kategoria e tretë është një nga kompetencat e zgjeruara komunale, domethënë kompetencat për kujdesin shëndetësor dytësor<sup>19</sup>, edukimin universitar<sup>20</sup>, fusha e kulturës<sup>21</sup> dhe të drejtat pjesëmarrëse në zgjedhjen e komandantit të policisë lokale<sup>22</sup>. Asnjë nga këto fuqi nuk është bartur te asnjëra nga komunat deri tani.

Përveç bartjes të pushtetit nga autoritetet qendrore, që ka ndikim në të gjitha komunat në Kosovë, komunat e reja janë gjithashtu në proces të marrjes të dokumentacionit të nevojshëm nga të ashtuquajturat "komuna-amë". Më 31 Mars 2010, kjo bartje e dokumentacionit është nisur formalisht nga MAPL, kur të gjitha komunat e reja kanë nënshkruar memorandume të mirëkuptimit me të gjitha komunat që janë prekur gjeografikisht dhe administrativisht nga krijimi i tyre, nga MAPL, nga Ministria për

---

<sup>13</sup> KIPRED intervistë me një zyrtar të lartë të MAPL, Korrik 2010

<sup>14</sup> Zhvillimi ekonomik lokal; planifikimi urban dhe rural; përdorimi i tokës dhe zhvillimi; implementimi i rregullave për ndërtim dhe standardeve për kontroll të ndërtimit; mbrojtja lokale e ambientit; furnizimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe komunale; përgjigja lokale urgjente; furnizimi i pre-parësorëve publik; edukimi primar dhe sekondar; promovimi dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore; ofrimi i kujdesit parësor shëndetësor publik; furnizimi me shërbime familjare dhe të tjera sociale; strehim publik; shëndetësia publike; licencimi i shërbimeve lokale dhe lehtësirave; emërtimi i rrugëve dhe vendeve të tjera publike; furnizimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe vendeve publike; turizmi; aktivitete kulturore dhe argëtuese.

<sup>15</sup> Raport periodik i grupeve punuese për decentralizim në MAPL, Mars 2010 dhe KIPRED. Intervistë me zyrtarë të MAPL, Qershor, Korrik 2010.

<sup>16</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 18

<sup>17</sup> Raport periodik i grupeve punuese për decentralizim në MAPL, Mars 2010

<sup>18</sup> Ibid

<sup>19</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 20, definojnë që komunat e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shterpçës do të kenë kompetencën për ofrimin e Kujdesit dytësor shëndetësor.

<sup>20</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 21, definojnë që komunat e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shterpçës do të kenë kompetencën për edukim të lartë

<sup>21</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 22, definojnë që komunat e Kosovës në të cilat komuniteti serb është mazhoritar do të ushtrojë përgjegjësinë në çështje kulturore

<sup>22</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 23, definojnë që komunat me mazhorancë serbe do të kenë të drejtë të avancuar pjesëmarrëse në zgjedhjen e komandantit të stacionit rajonal policor në pajtim me Ligjin për Policinë e Kosovës



Ekonomi dhe Financa (MEF), Ministria për Punë të Brendshme (MPB), dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK).

Kjo bartje e dokumenteve dhe të dhënave të tjera pritet të përfundojë brenda një periudhe prej tre muajve nga data e nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit. Sidoqoftë, marrëveshja parashikon që ne rast të ndonjë vonese, palët do të koordinojnë zgjatjen e kësaj periudhe kohore pa qenë të obliguar të nënshkruajnë ndonjë marrëveshje shtesë. Të dhënat që do të transferohen te komunat e reja përfshijnë të gjitha skedarët në letër si dhe në format elektronik. Ministrinë e Qeverisë si dhe AKK po e mbikëqyrin bartjen.

Megjithatë kjo bartje është vonuar ne komuna të ndryshme. Fillimisht, arsyeja kryesore për këtë vonesë ka qenë mungesa e vullnetit politik nga komunat amë për të vazhduar me bartjen. Më vonë filluan të shfaqen shumë probleme teknike. Në mes të listës të dokumenteve që duhej të barteshin ishte gjithashtu regjistri civil, i cili nuk është i kategorizuar gjeografikisht, kështu që shumë komuna duhej të bënin seleksionimin e skedarëve për tu bartur në mënyrë manuale. Në disa komuna këto regjistra kanë qenë të gatshme vetëm në letër duke e bërë bartjen akoma më problematike. .

Komuna e Graçanicës duhej të mblidhte dokumentacionin nga tre komuna ekzistuese: atë të Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Lipjanit. Komuna e Prishtinës tashmë e ka bartur të gjithë dokumentacionin dhe autoritetet në këtë komunë janë aktualisht duke bërë verifikimet e fundit të këtij procesi.<sup>23</sup> Komuna e Fushë Kosovës është në fazën e njëjtë.<sup>24</sup> Por, Komuna e Lipjanit është ballafaquar me disa probleme në këtë bartje. Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës janë munduar të pengojnë bartjen, sepse ata nuk pajtoheshin me kufijtë e ri komunal. Sidoqoftë, kjo çështje nuk është në kompetencat e autoriteteve komunale sepse është e definuar me ligj dhe është parimi kryesor i Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. Për më tepër, autoritetet e Lipjanit e kanë vonuar transferin e të dhënave të regjistrat civil te komuna e Graçanicës për shkak se këto regjistra ishin vetëm në letër, gjë që e ka bërë procesin e kopjimit dhe bartjes më të vështirë.<sup>25</sup> Bartja e këtyre skedarëve është momentalisht në vazhdim.

Komuna e Klllokotit/Vërbovacit është krijuar nga territori i Komunës së Vitisë. Deri tani, autoritetet në Viti vetëm sa kanë filluar procesin e bartjes të skedarëve te autoritetet e porsa zgjedhura të Klllokotit/Vërbovacit, autoritete këto që akoma janë në proces të punësimit të stafit dhe ndërtimit të kapaciteteve për të marrë këtë dokumentacion.<sup>26</sup> Skedarët e parë që do të dorëzohen janë të dhënat kadastrale dhe regjistri civil. Mirëpo autoritetet parashikojnë probleme me regjistrin civil, pasi që librat e vjetër janë marrë nga administrata serbe gjatë tërheqjes së tyre nga Kosova në 1999, dhe shumë familje serbe në këtë zonë nuk kanë marrë pjesë në procesin e regjistrimit civil të organizuar nga OKB në 2000.<sup>27</sup> Vështirësi të tjera teknike, si ato me sistemin e vjetër kadastral, mund ta pengojnë procesin e bartjes dhe ta vonojnë për një kohë më të gjatë.

---

<sup>23</sup> KIPRED intervistë me Muhamet Gashi, zëdhënës i Komunës së Prishtinës, Prishtinë, Korrik 2010.

<sup>24</sup> KIPRED intervistë me një përfaqësues të Komunës së Fushë Kosovës, Prishtinë, Qershor 2010

<sup>25</sup> KIPRED intervistë me Sefer Krasniqi, zyrtar i Komunës së Lipjanit, Prishtinë, Qershor, 2010

<sup>26</sup> KIPRED intervistë me Daut Xhemajli, shef i administratës në Komunën e Vitisë, Prishtinë, Qershor, 2010

<sup>27</sup> Ibid

Komuna e Ranillugut tanimë e ka marrë shumicën e dokumentacionit nga komuna amë e Kamenicës. Deri tani, autoritetet në Kamenicë kanë transferuar regjistrin civil, shumicën e skedarëve kadastral dhe të gjithë dokumentacionin financiar duke përfshirë të ardhurat e vetë komunës, të cilat ishin ndarë në bazë të strukturës së popullatës.<sup>28</sup> Dokumentacioni i vetëm që do të bartet në muajt e ardhshëm janë të dhënat martesore.<sup>29</sup> Kjo komunë ka qenë më efiçasja në përgatitjen e dokumentimit për bartje.

Pas bartjes complete të dokumentacionit dhe skedarëve, MAPL dhe MPB duhet të bëjnë procesin e verifikimit, i cili do të analizojë nëse komunat amë i kanë kryer detyrat e tyre si dhe të gjykojnë kualitetin e skedarëve të transferuar. Pavarësisht nga vonesat e shumta, MAPL konsideron që procesi do të përfundojë deri në fund të vitit dhe që komunat do të jenë plotësisht funksionale deri atëherë.<sup>30</sup> Duke pasur parasysh të gjitha vonesat dhe paqartësitë e aktorëve lokal dhe ndërkombëtarë për sa i përket procesit të decentralizimit, arrijtjet në përputhje me këtë periudhë kohore mbeten një sukses domethënës.

## V. Qeverisja në komunat e reja – mundësitë dhe sfidat

Komunave të porsa krijuara i është alokuar një buxhet prej më shumë se 3.2 milion euro, i cili është ndarë proporcionalisht duke u bazuar në popullatën që jeton në këto komuna. Graçanica ka një buxhet vjetor prej €1,791,035, Kllokoti/Vërbovaci €719,602, ndërsa buxheti i Ranillugut është €693,636.<sup>31</sup> Gjithashtu, Republika e Shqipërisë ka garantuar mbështetje financiare prej €400,000 për Graçanicën ndërsa Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë me organizata ndërkombëtare të tjera donatore<sup>32</sup> kanë garantuar mbështetje financiare dhe teknike për komunat e reja.

Komunat e reja do të kenë kompetenca të plota të vendosin dhe funksionalizojnë mekanizma për të rritur buxhetet e tyre nga të hyrat vetanake. Për më tepër, MAPL ka një fond rezervë prej €2.4 milion, i cili do të përdoret për të ndihmuar komunat e reja, nëse një ndihmë e tillë nevojitet.<sup>33</sup> Deri tani, komuniteti i donatorëve ka treguar interes për të investuar në këto komuna. Qeveria e Kosovës ka alokuar mbi €2 milion për ndërtimin e dy spitaleve – një në Graçanicë dhe një në Shterpçë.

Ekipi Përgatitor në koordinim nga MAPL, tanimë ka draftuar 30 projekte për investim në Partesh, të cilat do të dorëzohen autoriteteve të sapozgjedhura të kësaj komune.<sup>34</sup> Agjenci të tjera ndërkombëtare të zhvillimit tanimë kanë shpallur se do të përqendrohen në këto komuna në vitet në vijim.

Megjithatë, numri i stafit në këto komuna është shumë i vogël sepse kalkullohet vetëm personeli administrativ në komunë. Vija buxhetore për "mallra dhe shërbime" në këto

---

<sup>28</sup> KIPRED intervistë me Enver Ajvazi, shef i administratës në Komunën e Kamenicës, Prishtinë, Qershor, 2010

<sup>29</sup> Ibid

<sup>30</sup> KIPRED intervistë me Sadri Ferati, ministër i MAPL, Prishtinë, Qershor 2010

<sup>31</sup> Buxheti i Kosovës 2010

<sup>32</sup> DFID, USAID, SDC, UNDP, dhe agjenci të tjera të zhvillimit.

<sup>33</sup> KIPRED intervistë me Sadri Ferati, ministër i MAPL, Prishtinë, Qershor 2010

<sup>34</sup> Ibid

komuna është shumë e lartë, ndërsa vijat buxhetore për "paga dhe mëditje" është shumë e ulët. Qeveritë komunale, sipas ligjit, janë përgjegjëse për shpërndarjen e pagave dhe mëditjeve për të gjithë personelin në sferën publike duke përfshirë profesorë, doktorë dhe infermierë si dhe të gjithë administratën publike. Kjo nuk është e njëjtë në komunat e reja duke pasur parasysh që shërbyesit civil janë gjithashtu të punësuar nga sistemi paralel i Serbisë dhe janë pjesë e institucioneve paralele. Do të mbetet qeverive komunale të vendosin se si do të përfshijnë këta shërbyes civil në sistemin e Kosovës. Sidoqoftë, qeveritë komunale duhet të respektojnë grantet buxhetore të dedikuara për shëndetësi dhe arsim, duke u bazuar në grante të dhëna nga qeveria qendrore.

Sfidat kryesore për autoritetet komunale do të jenë ballafaqimi me strukturat paralele serbe të cilat akoma operojnë në këto zona, veçanërisht me shërbimet e sigurimit dhe inteligjencës. Serbia i ka parashikuar €42 milion për strukturat paralele në buxhetin e shtetit për 2010. Qeveria në Beograd nuk tregon ndonjë shenjë që do të ndryshojë politikën e saj për sa i përket pjesëmarrjes të komunitetit serb në institucionet politike të Kosovës. Përkundrazi, ajo po përdor mbështetjen financiare institucionale për të përforcuar institucionet paralele në Kosovë. Kjo politikë do të shkaktojë ndeshje të pashmangshme me politikën dhe pushtetin e autoriteteve të reja të zgjedhura komunale, që me siguri do të shkaktojë trazira politike dhe sociale.

Qeveritë e reja komunale do të ballafaqohen me konflikt të pashmangshëm me strukturat paralele, së pari në fushat e arsimit dhe shëndetësisë, që sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, janë kompetencë ekskluzive e komunave.<sup>35</sup> Do të jetë një sfidë e madhe, dhe në afat të shkurtër e pamundur, që komunat e reja të fusin këto institucione nën kontrollin e tyre, veçanërisht duke pasur parasysh që këto institucione kanë vepruar nën qeverinë e Serbisë për më shumë se një dekadë. Sfidat do të jetë akoma më e madhe në sistemin e edukimit, ku shkolat veprojnë me kurrikulumet e Serbisë dhe në të shumtën e rasteve nuk pranojnë asistencë nga autoritetet kosovare, përveç asaj financiare dhe rrogave.

Qeveria e Kosovës, nëpërmjet buxhetit të alokuar për ministrinë në nivelin qendror, do të investojë më shumë se €2 milion në këto tre komuna me shumicë serbe, shumë kjo që nuk përfshin investimet që janë të parapara të vinë nga autoritetet komunale. Megjithatë, as qeveria e Kosovës, as komuniteti ndërkombëtar, nuk kanë një strategji uniforme se si të merren me strukturat paralele. Çka mbetet shqetësuese është besimi në rritje në qeverinë e Kosovës që strukturat paralele në komunat e reja nuk përbëjnë një kërcënim konstant dhe që me politikën e Serbisë për ndarjen e Kosovës, Beogradi gradualisht do të tërheqë mbështetjen financiare prej këtyre strukturave.

Një hap shumë pozitiv në këtë kontekst është dalja e lartë në zgjedhje e serbëve lokal në zgjedhjet e organizuara nga Kosova. Kjo tregon që komuniteti serb ngadalë është duke u drejtuar nga Prishtina, veçanërisht ndërsa qeveria në Beograd është duke u përqendruar në veri dhe duke shtyrë për ndarjen eventuale të Kosovës. Zgjedhja e autoriteteve të ligjshme në komuna ka qenë kundërshtimi kryesor ndaj strukturave paralele.

Më 16 janar 2010, kryetari i sapozgjedhur i Shterpçës, Branislav Nikoliq, i ka përjashtuar strukturat paralele nga godinat komunale. Lideri paralel i kësaj komune, i zgjedhur në zgjedhjet e organizuara nga Serbia, është pajtuar me këtë vendim dhe nuk ka krijuar probleme. Gjithashtu nuk ka pasur probleme nga popullata lokale serbe. Nikoliq fitoi kundër kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dhe konsiderohet si lider

---

<sup>35</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 17

legjitim i komunës nga shqiptarët dhe serbët. Gjysma e elektoratit serb në këtë komunë votuan për të, gjë që efektivisht e ka delegitimizuar lidershipin paralel.

Lidershipi i komunave të serbëve të Kosovës, po ashtu do të ballafaqohet me presionin nga komunitetet e tyre për kryerjen e shpejtë të premtimeve të bëra gjatë fushatës zgjedhore, duke synuar përmirësimin e shpejtë të kushteve të jetesës. Kryetarët e ri e kuptojnë këtë dhe do të jenë të prirur për funksionalizimin e shpejtë të komunave dhe implementimin e projekteve zhvillimore dhe infrastrukturës komunale.

## **VI. Përfundime dhe Rekomandime**

Procesi i decentralizimit shënon suksesin më të madh në konsolidimin e bashkëjetesës në mes të shqiptarëve dhe serbëve në një Kosovë të pavarur. Decentralizimi po tregohet të jetë mjeti më i suksesshëm për të ruajtur dhe zhvilluar karakterin multietnik të vendit. Megjithatë, pjesëmarrja e serbëve në zgjedhjet e Kosovës ka qenë vetëm një sukses preliminar. Autoritetet Kosovare duhet të vazhdojnë me përfundimin e decentralizimit, duke përmirësuar pushtetin e vet, të deleguar dhe të zgjeruar të komunave. Komunitat e reja ballafaqohen me sfida që duhet të adresohen në periudhën afatshkurtër në mënyrë që të mos humbet momentum i politik dhe mbështetja e komuniteteve serbe në Kosovë.

Në mënyrë që të përmirësohen dinamikat aktuale të procesit të decentralizimit, të mënjanohet zvogëlimi i rëndësisë së tij dhe të fuqizohen qeveritë e porsazgjedhura komunale, KIPRED-i rekomandon që:

1. Qeveria e Kosovës duhet të përshpejtojë procedurën e fuqizimit të komunave serbe me kompetenca të shtuara komunale, të bazuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Këto kompetenca të shtuara, veçanërisht ato në fushat e arsimit, kulturës dhe të drejtave pjesëmarrëse në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve lokale policore, do të rrisin besimin që komuniteti serb po e krijon në sistemin kosovar dhe do të zvogëlojë rolin e strukturave paralele të Serbisë.
2. Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë me përfundimin e legjislacionit për huamarrje që do të mundësojë komunave të draftojnë plane afatshkurtra, afatmesme, dhe strategji zhvillimore. Kuvendi i Kosovës duhet të ratifikojë dhe adoptojë këtë legjislacion sa më shpejtë të jetë e mundur.
3. Komunitat amë duhet të përshpejtojnë procedurën e bartjes së skedarëve të komunat e reja. MAPL dhe institucione të tjera kombëtare duhet të ndihmojnë në këtë proces.
4. Komunitat e reja duhet të vazhdojnë të punësojnë personelin e ri sa më shpejtë të jetë e mundur. Prioritet duhet të jepet punësimit të personelit që duhet të marrë skedarët dhe dokumentacionin prej komunave amë, në mënyrë që shërbimet komunale të bëhen funksionale.
5. Qeveritë komunale duhet të draftojnë legjislacionin sekondar që është i nevojshëm për decentralizimin e mëtejshëm të pushtetit duke e respektuar principin e subsidiaritetit.